



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 31 korrik 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: qershor, 2024

- Në qershor të vitit 2024, norma mesatare e interesit të totalit të kredive është 5,47% dhe shënoi rënie mujore prej 0,02 p.p., me rritje vjetore prej 0,35 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave është rritur në bazë mujore dhe vjetore për 0,02 p.p., respektivisht 0,48 p.p. dhe është 1,88%.
- Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara² në qershor është 5,08% dhe shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,11 p.p., respektivisht 0,18 p.p. Norma mesatare e interesit për depozitat e sapo pranuar është më e lartë për 0,16 p.p. në bazë mujore dhe është 2,52%, me rënie vjetore prej 0,18 p.p.

Tabela 1. Norma të interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	6.2023	7.2023	8.2023	9.2023	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.12	5.49	5.49	5.49	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47
Korporatat	4.86	5.36	5.36	5.37	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26
Amviseritë	5.35	5.61	5.61	5.61	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66
Kreditë e reja	5.26	5.57	5.53	5.49	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08
Korporatat	5.26	5.75	5.73	5.50	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95
Amviseritë	5.27	5.32	5.24	5.47	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29
Depozitat	1.40	1.50	1.55	1.59	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88
Korporatat	1.99	2.02	2.08	1.94	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25
Amviseritë	1.34	1.44	1.50	1.55	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84
Depozitat e reja	2.70	2.21	2.17	2.15	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52
Korporatat	2.11	1.57	1.81	1.65	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39
Amviseritë	2.87	2.40	2.32	2.40	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55

Burimi: BPRMV.

¹Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shih metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf


²Lidhur me normat e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike lëvizje të ndryshueshme. Lëvizjet e këtilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord e interesit.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

1. Normat e interesit në sektorin korporativ³


- Në qershor 2024, norma mesatare e interesit të totalit të kredive të sektorit korporativ është 5,26% dhe në bazë mujore është ulur me 0,05 p.p. Në të njëjtën kohë, ndryshimi në rënie vjen si pasojë e rënies së normave të interesit për të gjithë komponentët: normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për përkatësisht 0,04 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë interesi është rritur për 0,40 p.p.




Burimi: BPRMV.



- Këtë muaj, norma e interesit për kreditë e sapo miratuara për sektorin korporativ është ulur për 0,21 p.p. në bazë mujore dhe është 4,95%. E analizuar sipas valutës, rënia mujore është rezultat i rënies të normave të interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,99 p.p., përkatësisht 0,25 p.p.) në kushte kur normat e interesit të kredive në valutë të huaj janë rritur (për 0,95 p.p.). E analizuar në bazë vjetore, norma e interesit për kreditë e sapo miratuara për sektorin korporativ është ulur me 0,31 p.p.)



Burimi: BPRMV.





³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Në muajin qershor, norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ u rrit për 0,04 p.p. krahasuar me një muaj më parë, dhe është 2,25%. Ndryshimi në rritje në tërësi është rezultat i rritjes së normave të interesit për depozitat në valutë të huaj (për 0,11 p.p.), ndërsa normat e interesit për depozitat në denarë pa dhe me klauzolë valutore janë të pandryshuara. Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ shënoi rritje prej 0,26 p.p.
- Norma e interesit për depozitat e sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ, këtë muaj është 2,39% dhe shënon rritje mujore prej 0,01 p.p. Gjithashtu, ndryshimi në tërësi është rezultat i rritjes së normave të interesit për depozitat në valutë të huaj (me 0,15 pikë përqindje). Në qershor, te bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të sapo pranuar me klauzolë valutore, ndërsa normat e interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore shënuan rënie (për 0,11 p.p.). Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është zvogëluar për 0,28 p.p.

2. Normat e interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV.

- Në qershor, norma e interesit të totalit të kredive të amvisërive është 5,66% dhe shënoi rritje mujore prej 0,01 p.p. Në të njëjtën kohë, rritja vjen nga rritja e normave të interesit për kreditë në denarë pa klauzolë valutore (për 0,02 p.p.), në kushtet kur normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore janë të pandryshuara, ndërsa normat e interesit të kredisë në valutë të huaj shënuan ulje (me 0,01 p.p.). Rritja vjetore e normës së interesit të totalit të kredive për amvisëritë është 0,31 p.p.


⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normave të interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Këtë muaj, norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara për amvisëritë shënoi rritje mujore prej 0,03 p.p. dhe është 5,29%. Ndryshimi është në tërësi për shkak të rritjes së normave të interesit për kreditë në denarë pa klauzolë valutore (për 0,09 p.p.), ndërsa normat e interesit për kreditë në valutë të huaj dhe kreditë në denarë me klauzolë valutore kanë shënuar rënie (për 0,21 p.p., përkatësisht 0,02 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,02 p.p.



Burimi: BPRMV.



- Në qershor 2024, norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ është 1,84% dhe shënoi rritje mujore prej 0,03 p.p. Analizuar sipas valutës, ndryshimi rezulton nga rritja e normave të interesit për depozitat në valutë të huaj dhe depozitat në denarë pa klauzolë valutore (për 0,03 p.p., përkatësisht 0,02 p.p.), në kushtet e rënies së normave të interesit për depozitat në denarë me klauzolë valutore (për 0,06 p.p.). Rritja vjetore e normave të interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ është 0,50 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive⁶, këtë muaj është rritur me 0,19 p.p. dhe është 2,55%. Njëkohësisht, rritja është për shkak të normave më të larta të interesit për depozitat në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit për depozitat në valutë të huaj (për 0,25 p.p., përkatësisht 0,14 p.p.). Edhe këtë muaj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të sapo pranuar në denarë me klauzolë valutore. Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është zvogëluar për 0,32 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 gusht 2024 (mesatarja referuese, përfshirë korrikun e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235, lok. 108/110.